

Komentet e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së, Ambasadorit Eugen Wollfarth, pas takimit me z. Sinan Tafaj, President i Këshillit Kombëtar të Shoqatave të Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe President i Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë.

TIRANË - 20 korrik 2012

Ambasadori Wollfarth: Sot është pikërisht dita, ditë që kisha kohë që e prisja me kënaqësi, qëkur Dr. Tafaj me ftoi për të vizituar selinë e Shoqatës së Personave të Verbër. Ja ku jam sot bashkë me disa anëtarë të ekipit tim. Ne biseduam për disa aspekte të gjithëpërfshirjes. Anëtarët e një pjese shumë të rëndësishme të shoqërisë, të cilët kanë aftësi të kufizuara, duhet të ndihmohen që ta shohin veten si anëtarë me të drejta të plota në shoqëri. Për këtë, atyre u duhet ndihmë nga të gjitha nivelet. Ndërgjegjësimi në Shqipëri për këtë çështje është rritur, por ai duhet të jetë edhe më i madh sa i takon asaj çka u nevojitet të verbërve, personave me forma të tjera të aftësisë së kufizuar, dhe sjelljes së tyre në jetë, në mënyrë që ata të jetojnë sipas standardeve dhe që të arrijnë më lehtë në qendër të shoqërisë. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri e mbështet fuqishëm këtë qëllim. Ne kemi edhe disa aktivitete të përbashkëta dhe e ofrojmë këtë mbështetje së bashku me partnerë të tjerë ndërkombëtarë dhe fundacione të rëndësishme këtu në Shqipëri, që mbështesin personat me aftësi të kufizuara. Shumë të rëndësishme ne konsiderojmë edhe diskutimet e gjalla që organizon Forumi i të Rinjve, të cilat çojnë në një jetë më të mirë në Shqipëri. Në bërjen e ligjeve të reja, është gjithashtu po aq e rëndësishme që të dëgjohet zëri i shoqërisë civile, përfshirë edhe zëri i personave me aftësi të kufizuara. Pra, këto janë çështje që ne duhet t'i çojmë përpara, të vazhdojmë t'i çojmë përpara dhe këto janë fusha legjitime bashkëpunimi, sidomos në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara. Dr. Tafaj më tregoi se ai dhe shoqata e tij po planifikojnë disa aktivitete të veçanta për muajin tetor. Ne do të marrim pjesë me kënaqësi në këtë përpjekje dhe unë dëshiroj ta falënderoj atë për ftesën. Vërtet që jam shumë i kënaqur që jam këtu sot. Dr. Tafaj, faleminderit shumë dhe ju siguroj se ne do të vazhdojmë ta mbështesim punën në të mirë të personave me aftësi të kufizuara.

Pyetje: Qeveria shqiptare ndonëse po mbështet personat me aftësi të kufizuara, duke nxitur politikat e punësimit për ta, ka bërë ndryshime të ligjit duke reduktuar masën e kompensimit për këtë kategori njerëzish. A mendoni se është i drejtë ky vendim i qeverisë shqiptare, çka edhe në njëfarë mënyre ka revoltuar personat me aftësi të kufizuar?

Ambasadori Wollfarth: Është shumë e rëndësishme që njerëzit me aftësi të kufizuara të gjejnë mbështetjen që u nevojitet nga shoqëria në mënyrë që të bëjnë një jetë sa më normale. Për pasojë, do të thosha se njëfarë mbështetjeje për kostot e jetesës do të ishte një kontribut i drejtë i shoqërisë për ta bërë jetën e tyre sa më normale. Nga ato që kemi parë, kuptoj se kostot e jetesës për njerëzit me aftësi të kufizuara janë deri diku më të larta se ato të personave normalë. Pra, njëfarë ndihme është e drejtë dhe e justifikuar, por masa apo forma e kësaj ndihme, apo gjetja e një ekuilibri varet nga negociatat, nga buxheti, dhe gjithashtu nga marrëveshjet e veçanta, sidomos kur në to përfshihen partnerë privatë, i cili në rastin në fjalë do të ishte një kompani që ofron energji elektrike.

Pyetje: Ndërkohë Qeveria shqiptare nuk ka nënshkruar Konventën e Aftësisë së Kufizuar, por ndërkohë ka nisur me ndryshimin e ligjeve. Kështu funksionon? Duhet bërë më parë ndryshime në ligje pa u nënshkruar Konventa apo duhet më parë të nënshkruhet Konventa dhe pastaj të bëhen ndryshime të ligjeve?

Ambasadori Wollfarth: Për mua është e rëndësishme që personat me aftësi të kufizuara të ndihmohen nga shoqëria dhe që ne të shohim një nivel të lartë ndërgjegjësimi. Ata kanë nevojë për mbështetje, duke përfshirë edhe mbështetjen nga qeveria. Dhe kur them qeveria nuk e kam fjalën vetëm për qeverinë qendrore, sepse shumë punë mund të bëhet edhe nga pushteti vendor dhe nga shoqëria civile që jeton në qytete dhe në fshatra – për të ndihmuar në lehtësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe për të punuar në drejtim të gjithëpërfshirjes. Sa i përket rendit të gjerave, se si mund të arrihet kjo, mund të them se mundësitë janë të ndryshme.

Pyetje: Në fakt, një nga detyrimet për aderimin e Shqipërisë në BE është edhe integrimi i disa kategorive ku bëjnë pjesë edhe personat me aftësi të kufizuara. Ndërkohë që vetë personat me aftësi të kufizuar e ndjejnë veten më keq sot sesa katër apo pesë vite më pare. Ata thonë se të drejtat e tyre me kalimin e viteve po reduktohen, pra benefitet që ata kanë përfituar po bien, ndërkohë që ne jemi në prag të miratimit të Konventës, çfarë nënkupton se të drejtat e tyre duhet të ishin më mirë se nga sa kishin përfituar katër apo pesë vite më pare. Pra ne po shkojmë drejt një regresi sesa drejt një progresi.

Ambasadori Wollfarth: Faleminderit për pyetjen! Mendoj se Dr. Tafaj mund t'i përgjigjet shumë më mirë kësaj pyetjeje, sepse ai ka jetuar në Shqipëri gjatë gjithë kohës. Unë kam dy vjet këtu. Kam parë progres. Kam parë gjithashtu fusha ku vazhdon ende debati, siç është edhe pyetja të cilës iu përgjigja. Është një sfidë e vazhdueshme. Ka të bëjë me ndërgjegjësimin dhe me atë çka mund të bëhet. Dr. Tafaj, nëse më lejon të shtoj diçka para se të merrni fjalën? Do të doja të shtoja se nga këndvështrimi i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri është shumë e rëndësishme të mendojmë për sfidat me të cilat duhet të jetojë një person me aftësi të kufizuara për të qenë si çdo anëtar tjetër i shoqërisë. Këta njerëz kanë nevojë për mbështetje. Ne ofrojmë bashkëpunim dhe në fakt kemi bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe me Shoqatën e të Verbërve. Unë do të ftoja shoqërinë civile t'i bashkohet këtyre përpjekjeve, si dhe autoritetet që të bëjnë sa munden në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara.

FUND